

Salzburg, Mars 2013

Testimi standard gjuhë angleze klasa e 8., Anglisht „Gjuhë e folur“, NMS-Evaluation

Të nderuara nëna, baballarë dhe edukatorë!

Me një amendament për ligjin mbi mësimdhënien në shkollë u krijua baza ligjore për futjen e standardeve arsimore. Këto standardet përcaktojnë se çfarë duhet të kenë përvetësuar nxënësit në fund të nivelit të 8-të në lëndët gjermanisht, matematikë dhe anglisht. Testimi i këtyre standardeve jep informacion mbi suksesin e mësimdhënies dhe alternativa për përmirësimin e sistemit arsimor austriak.

Pas testimit standard në lëndën e matematikës në vitin e fundit shkollor do të organizohet në nivelin e 8-të si fillim testimi gjithëpërfshirës i standardeve arsimore në **Anglisht**. Do të testohen 1.400 shkolla në të gjithë Austrinë. Cikli i testimit do të fillojë në vitin e ardhshëm shkollor në lëndën e gjuhës gjermane.

Testi standard në anglisht – ku do të marrë pjesë vajza/djali juaj – do të organizohet **të mërkurën, më 17 Prill 2013, ose të enjten më 25 Prill 2013**. Ora e saktë e testimit do tu bëhet e ditur nxënësve në kohën e duhur nga drejtuesi i klasës.

Testi do të administrohet nga mësuesit e shkollës të trajnuar posaçërisht për diçka të tillë. Në 7% të klasave që do të testohen, testi do të drejtohet nga një mësues/e e një shkolle tjetër. Testi, i cili përbëhet nga 3 pjesë „**Dëgjimi**” (pjesa 1), „**Leximi**” (pjesa 2), „**Shkrimi**” (pjesa 3), zgjat 3 orë dhe fillon me orën e parë të mësimin.

Testimi do të jetë i organizuar si më poshtë:

Përhëndetja, Sqarimi të përgjithshme (rreth 5 minuta) - Dëgjimi, përfshirë udhëzimet (rreth 40 minuta) – Pushimi (10 minuta) - Leximi, përfshirë udhëzimet (rreth 40 minuta) - Pushimi (10 minuta) - Shkrimi, përfshirë udhëzimet (rreth 40 minuta) - Pushimi (10 minuta) – Pyetësori (rreth 20 minuta)

Pyetësori që nxënësit plotësojnë në fund të testit, shërben për përshkrimin e kushteve të të përgjithshme të mësimdhënies brenda dhe jashtë shkollës.

Rezultati i marrë, i cili do të jetë gati nga fundi i semestrit të parë të vitit të ardhshëm arsimor, do të prodhojë informacion se deri në çmasë nxënësit kanë arritur të absorbojnë vërtetë kompetencat e synuara. Drejtuesit e shkollës dhe mësuesit e anglishtes së klasave të 8-ta të testuara marrin rezultatet e përmbledhura, **anonime** të testimit, të cilat mundësojnë zhvillimin e shkollës dhe mësimdhënies së bazuar në fakte. (Nga raportet e mësuesve dhe ato të shkollës nuk është e mundur të nxirren rezultate për nxënës individualë!) Nga këto informacione gjenerohen raporte për inspektorët e shkollave në rang lokal dhe federal.

Në ditën e testit nxënësit shpëputin **nga testi kodin e tyre personal**, me anë të së cilit ata mund të futen në internet dhe të marrin **rezultatet e testit të tyre**. Me këtë kod personal pajisen vetëm nxënësit. **Në rastin kur ky kod humbet BIFIE nuk është në gjendje ta zëvendësojë atë** pasi tek BIFIE nuk është i mundur klasifikimi i rezultateve/kodeve për secilin nxënës – kjo bëhet vetëm për arsye të mbrojtjes së të dhënave. **Për këtë arsye është e rëndësishme që nxënësit ta ruajnë mirë këtë kod ose tua besojnë Juve atë!**

Anglisht „Gjuhë e folur“

Kompetencat në fushën e gjuhës angleze „gjuhë e folur“ do të testohen në 120 shkolla në të gjithë Austrinë, përzgjedhja do të jetë rastësore. Për çdo shkollë do të testohen maksimalisht 24 nxënës. Vajza/djali Juaj mund të përzgjidhet rastësisht për të marrë pjesë në këtë test të gjuhës së folur. Testi do të organizohet **në periudhën kohore Maj/Qershor 2013**. Informacioni mbi pjesëmarrjen, orën e saktë të testimit apo procedurat e testimit do tu bëhen të ditura nxënësve në kohën e duhur nga drejtuesit përkatës të klasave.

Testi i gjuhës së folur do të kryhet nga një komision drejtues (dy mësues nga një shkollë tjetër), të cilët janë trajnuar posaçërisht për diçka të tillë. Nxënësit janë të lutur të marrin pjesë dyshe në një bisedë që do të zgjasë rreth 20 minuta. Kjo bisedë përbëhet nga dy faza, një fazë me karakter monologu dhe tjetra me karakter dialogu.

Kur të merrni rezultatet e testit të gjuhës angleze do t’ju bëhen të ditura edhe rezultatet e „Gjuhës së folur“.

NMS-Evaluation

Vajza/djali Juaj frekuenton një klasë NMS të gjeneratës së dytë. Në fund të këtij viti akademik do të organizohet sondazhi përfundimtar për vlerësimin e shkollave të mesme të reja. Në fillim të nivelit të 5. shkollor (nëntor/dhjetor 2009), në kuadër të këtij studimi u testuan kompetencat për futjen në NMS. Nxënësit të cilët pas frekuentimit katër vjeçar të NMS kanë arritur të përfundojnë nivelin e dytë të shkallës I, do të testohen sërish në nivelin e 8. arsimor. Në sondazh do të marrin pjesë rreth 105 pika NMS-je nga e gjithë Austria, përzgjedhja do të jetë rastësore. Testi përfshin njohuri nga matematika dhe gjuha gjermane si dhe një test mbi aftësitë njohëse (detyra të përgjithshme mendimi). Gjithashtu do të plotësohet edhe një pyetësor për nxënësit.

Studimi do të organizohet në një ditë normale shkolle midis datës **3. dhe 14 qershor 2013** dhe do të drejtohet një person i jashtëm i cili nuk jep mësim në shkollën e fëmijës Suaj. Informacioni mbi orën e saktë të testimit apo procedurat e testimit do tu bëhen të ditura nxënësve në kohën e duhur nga drejtuesit përkatës të klasave.

Testi fillon me orën e parë të mësimin, zgjat rreth 3 orë dhe do të procedohet si më poshtë:

Përhëndetja, Sqarime të përgjithshme (rreth 10 minuta) - Pjesa I e testit përfshirë udhëzimet (rnaks. 45 minuta) – Pushimi (10 minuta) - Pjesa 2 e testit përfshirë udhëzimet (rnaks. 45 minuta) - Pushimi (10 minuta) - Pjesa 3 e testit përfshirë udhëzimet (rnaks. 20 minuta) - Pushimi (10 minuta) – Pyetësori (rreth 35 minuta)

Tek NMS-Evaluation nuk bëhen të ditura rezultatet individuale.

Përfshirja e nxënësve në studime të tilla që lidhen me standardet e arsimimit dhe NMS-Evaluation është i detyrueshëm, kjo bazuar në ligjin BIFIE (BGBl. I Nr. 25/2008, § 6 Paragrafi. 2 idF BGBl. I Nr. 113/2009). Të gjitha të dhënat personale të nxënësve do të mbledhen në mënyrë indirekte për secilin prej tyre. Të gjithë punonjësit e institutit BIFIE janë të detyruar të zbatojnë ligjin BIFIE (BGBl. I Nr. 25/2008, § 3 Paragrafi 2 idF BGBl. I Nr. 113/2009) mbi ruajtjen e fshehtësisë e këtyre të dhënave.

Ju lutem vini re, fleta me informacionet përkatëse gjendet në Homepage BIFIE në gjuhë të ndryshme dhe mund të shkarkohen nga prindërit ose kujdestarët.

Përkthimet: www.bifie.at/node/2009

Dëshironi të dini më shumë mbi standardet e arsimit dhe NMS-Evaluation ?

Informacione të mëtejshme Ju mund të gjeni në fletën shoqëruese ose në Homepage-in tonë, ku mund të gjeni edhe shembuj detyrash:

Testi standard Anglisht: www.bifie.at/node/1822

NMS-Evaluation: www.bifie.at/schueler-eltern/nms-evaluation

Nëse keni pyetje ose nëse keni nevojë për ndihmë atëherë BIFIE ju mirëpret gjithmonë këta numra telefoni:


Testimi: **Tel.: 0662/620088-3500; E-Mail: bist8@bifie.at**

Rezultatet: **Tel.: 0662/620088-3700; E-Mail: bist8-rm@bifie.at**

Gjithashtu ju mund t'i drejtoheni edhe institucioneve që përfaqësojnë shoqatat e prindërve. Në këtë rast ne ju lutemi të kontaktoni – në varësi të rastit tuaj – ose **Shoqatën austriake të prindërve të shkollave të detyrueshme publike** (Tel.: 01/53120-3112; Celular: 0699/153 120 00; E-Mail: office@elternverein.at), **Shoqatën federale të prindërve të shkollave të mesme dhe të larta austriake** (Tel.: 01/53120-3110; Celular: 0680/141 1 142; E-Mail: office@bundeselternverband.at) ose për shoqatën e prindërve të të gjitha shkollave private katolike drejtoheni tek **Shoqata kryesore e shoqatës katolike të prindërve në Austri** (Tel.: 07224 4311; E-Mail: bvkev@mautnermarkhof.at).

Ne ju falënderojmë në avancë për mbështetjen tuaj!

Përshendetje miqësore



Dr.ⁱⁿ Claudia Schreiner
Drejtoria BIFIE Salzburg